Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe Rregulloren Nr. 03/2023, për Procedurat e Hetimeve Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 19.04.2024, nxjerrë këtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION
Dep. DPKI
Nr.Prot. Br.Prot. Prot No. 621/24
Nr.i Faq. Br. Str. 03
Data Datum Date 23.04.24

VENDIM

I. Mbyllet rasti APK-DPKI-06-1696/23, për zyrtarin e lartë z. Burim Shala, Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A në Prizren, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrim të funksionit publik, duke hequr dorë nga funksioni menaxhues në ndërmarrje private.

II. Ushtrimi i funksionit Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A në Prizren dhe njëkohësisht Kryetar i degës së Shoqatës së invalidëve të luftës së UÇK-së - Dega në Prizren, nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit.

III. Nuk qëndron pretendimi që krahas ushtrimin të funksionit Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A në Prizren, që i njëjti e ushtrun edhe funksionin Shef i Shërbimeve Juridike në Spitalin Rajonal në Prizren.

IV. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Arsyetim

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të një raportimi anonim ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

I. Agjencia në pajtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Pas kësaj, zyrtari i lartë është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, sepse kjo është e ndaluar me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

"1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*".

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit përkatësisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Shala ka ndërmarrë veprimet e nevojshme duke u larguar nga funksioni i përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat "B Group" Sh.P.K, dhe "Burim AM Shala" B.I, si dhe është në proces të ndryshimit të përfaqësuesit të autorizuar në biznesin privat "N&D Granit" Sh.P.K, për faktin se bashkëpronari i këtij biznesi jeton jashtë Kosovës. Zyrtari i lartë ka parashtruar kërkesën për ndryshim të përfaqësuesit të autorizuar në këtë biznes. I njëjti është deklaruar se ky biznes nuk ka zhvilluar aktivitet që nga viti 2013. Gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar i lartë publik z. Shala nuk ka të drejtë të ndërmarrë ndonjë veprim menaxherial në këtë biznes privat. Për ndryshimet e kërkuara në këtë biznes privat do të mbikëqyret nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit deri sa të mbyllet procedura.

II. Zyrtari i lartë është trajtuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A në Prizren, dhe njëkohësisht Kryetar i degës së shoqatës së invalidëve të luftës së UÇK-së - Dega në Prizren.

Lidhur me këtë, Agjencia ka kërkuar dhe pranuar dokumentacionin relevant nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkitazi për organizatë Joqeveritare Shoqatës së invalidëve të luftës së UÇK-së, është konstatuar se përfaqësues i autorizuar – Kryetar i kësaj organizate joqeveritare është dikush tjetër (F.Sh).

Lidhur me këtë, ushtrimi i funksionit Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A në Prizren, dhe njëkohësisht Kryetar i degës së shoqatës së invalidëve të luftës së UÇK-së - Dega në Prizren nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit referuar Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

III. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me pretendimin për ushtrimin e funksionit Kryeshef Ekzekutiv në Ndërmarrjen Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave "Ekoregjioni" Sh.A në Prizren dhe njëkohësisht Shef i Shërbimeve Juridike në Spitalin Rajonal në Prizren, Agjencia ka kërkuar dhe pranuar informacion nga Spitali Rajonal në Prizren,

Nga shkresa zyrtare e pranuar nga Spitali i Përgjithshëm në Prizren konstatohet se tanimë ish i punësuari Burim Shala, Shef i Shërbimeve Juridike në Spitalin Rajonal në Prizren e ka përfunduar marrëdhënien e punës në këtë institucion qysh me datë 15.12.2022.

Për pretendimin e ngritur për konflikt interesi lidhur me atë se zyrtari i lartë ka përfituar kontratë prokurimi nga Komuna e Prizrenit, ky pretendim është në procedurë të shqyrtimit të konfliktit të interesit, për shkak se në kuadër të këtij rasti, një palë e tretë, ka ngrit edhe pretendime të tjera që lidhen me përfitimin e kësaj kontrate.

IV Agjencia vendosi duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin është përcaktuar se: "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj

Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit